



Në bazë të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17, nenit 24 dhe nenit 40 paragrafi 2 shkronja c) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), dispozitave të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, dispozitave Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit Nr. 05/L -108 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.3, nenit 57 dhe nenit 63 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 29.04.2021 miraton këtë:

## V E N D I M

### Për bartjen e rezervave të investimeve kapitale

1. **Miratohet vendimi për bartjen e mjeteve rezervë në kuadër të investimeve kapitale në shumën prej 265,000.00€ (dyqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë euro).**
2. Mjetet rezervë të cekura në pikën 1 të këtij vendimi të barten si në vijim si në vijim:
  - 2.1. Në programin Shërbimet Publike (180), nën programi Infrastruktura Publike (18171), kodi funksional (0451).
    - 2.1.1. Ndërtimi i kanalit për ujëra atmosferik dhe ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni në fshatin Zatriq, Grandi (10) në shumën prej 34,000.00€.  
Të hyrat vetanake (21) në shumën prej 20,000.00€.  
**Gjithsej: 54,000.00€**
  - 2.2. Në programin Planifikimi urban dhe mjedis (660), nën programin planifikimi urban dhe inspeksion (66360), kodi funksional (0620).
    - 2.2.1. Ndërtimi i shtratit të përroit në lagjen Kelmendi në Kramovik, Grandi (10) në shumën prej 6,000.00€.  
Të hyrat vetanake (21) në shumën prej 65,000.00€.  
**Gjithsej: 71,000.00€**
  - 2.3. Në programin Shëndetësi (737), nën programi Shëndetësi (73700), kodi funksional (0721).
    - 2.3.1. Renovimi i objektit të vjetër të QKMF-së në Rahovec, Grandi (10) në shumën prej 140,000.00€.
3. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-në dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës së Rahovecit.

***Vendimi u dërgohet:***

- *Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

**KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT**

**01 Nr.188/21**  
**Datë:29.04.2021**

